

II. Standartet e kontabilitetit të zbatueshina

RAPORT

Në përputhje me ligjin, Nr.25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", partitë politike, kushtetuesit dhe njësitë jo fitimprurëse dhe janë objekt i Standartet të Kontabilitetit të Partisë së Gjelbër të Fitimprurëse (SKF për QJ-të).
PER
AUDITIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR 2020
TË PARTISË SË GJELBËR
 (Hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja)

Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
 Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Jam angazhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve(KQZ) në misionin e auditimit ligjor të detyrueshëm, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020 nga Partia e Gjelbër, të raportuara prej saj në raportin vjetor financiar (Pasqyrat financiare) , të depozituara në KQZ-ë.

Me përfundimin e procesit të auditimit, po ju paraqes raportin e hartuar sipas formatit të standartizuar të miratuar nga KQZ-ja.

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri ligjor

Ashtu siç referohet dhe në kontratën e shërbimit, auditimi ligjor i raporteve vjetore financiare të partive politike kërkohet dhe realizohet në zbatim të kerkesave të:

- Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar
- Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar,
- Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",
- Legjislacionit në fushës fiskale, si dhe
- Akteve nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim.

Nga pikëpamja profesionale kryerja e auditimit ligjor bazohet në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) të miratuara dhe të publikuara nga bordi i standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të dhënies së sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), të detyrueshme për zbatim nga ligji për auditimin i sipërcituar.

AUDITIMIN
 LIGJORIN
 VIOLETA MULLA
 ANETARE E I.E.K.A.

ii. Standartet e kontabilitetit të zbatueshme

Në përputhje me ligjin, Nr.25/2018, datë 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", partitë politike kanë statusin e njësisve jofitimprurëse dhe janë objekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikuat i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të).

Sipas këtij standardi organizatat jo fitimprurëse që kanë shifrën e aktivitetit ose shifrën e të ardhurave më të madhe se 5 milion lekë, zbatojnë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuar dhe duhet të paraqesin pasqyrat financiare që përbëhen nga: pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e aktiviteteve, dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, si dhe japin shënime shpjeguese e informacione të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteteve që kryejnë.

Partia e Gjelbër kategorizohet në grupin e sipërpërmendur dhe duhet të përgatisë pasqyrat financiare (raporte vjetore) sipas këtyre kërkesave.

B. OBJEKTI I AUDITIMIT


i. Kontrata e shërbimit

Për përmbushjen e misionit të auditimit, me palën angazhuese KQZ-në, u lidh kontrata e shërbimit nr 6257 me datë 08.09.2021, me objekt: "Kryerja e auditimit të detyrueshem të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, dhe /ose aktve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendes, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratur", i ndryshuar dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre".

Përveç kontratës së mësipërme, në datën 04.10.2021 është lidhur kontrata me partinë politike "Partia e Gjelbër", me qëllim që të dokumentojë dhe konfirmojë pranimin dhe kushtet e angazhimit, si palë përgjegjëse e raportimeve financiare që do të auditohen.

ii. Vendimi i KQZ-së

Në përputhje me kuadrin rregullator të përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve kontabël të licencuar për auditimin e partive politike, KQZ-ja me vendimin 6257 datë 08.09.2021 më ka emëruar si auditues të Partisë së Gjelbër.



iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Përgjegjësitë e drejtimit të partisë

Auditimi do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për financat në parti të politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë), pranon dhe kupton se ka përgjegjësi:

- a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare (raportit vjetor) në pajtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimprurese (SKK për OJF-të) dhe me kërkesat specifike të ligjit "Për Partitë Politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- b) Për kontrollet e brendshme të atilla që drejtimi partisë i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi; dhe
- c) T'i japë audituesit:
 - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
 - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit; dhe
 - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda partisë nga të cilët audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, do të kërkoj nga drejtimi i partisë dhe, kur të jetë e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të marr prej tyre konfirmime me shkrim lidhur me deklaratimet me gojë që do të bëhen në lidhje me auditimin.

Përgjegjësitë e audituesit

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që të respektoj kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, do të ushtroj gjykimin profesional dhe do të mbaj skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Objektivat janë që të arrij një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar), në tërësi, nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshoj një raport auditimi që përfshin opinionin tim. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Gjithashtu kam dhe përgjegjësi të tjera raportuese, që burojnë nga termat e kontratës, për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimeve ekonomike dhe financiare që lidhen me kërkesat specifike të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë

Politike”, i ndryshuar dhe udhëzimet e KQZ-së, me burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, dokumentimit dhe regjistrimit të tyre, identifikimin e dhuruesve, publikimin e tyre, etj.

C. INFORMACION MBI SUBJEKTIN POLITIK

i. Prezantimi i subjektit politik

Partia e Gjelbër, është themeluar në 1 shtator 2001 dhe vepron në përrputhje me ligjin nr.8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, statutin e saj dhe kuadrin ligjor shqiptar.

Partia e Gjelbër (PGJ) është një organizim politik i qytetarëve, të grupuar me vullnet të lirë mbi bazën e ideve, bindjeve dhe interesave politike, me struktura të organizuara mbi bazën e ndarjes territoriale, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit në organet e pushtetit. Burimet financiare të Partisë përbëhen nga granti që jep donatori i huaj (fonde jopublike) në përputhje me sa parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Partia e Gjelbër si person juridik, është e regjistruar në sistemin tatimor me NIPT-in L21730451A dhe ka bërë deklaratimet e duhura sipas përgjegjesive tatimore dhe aktivitetit që ajo ka kryer. Gjithashtu ajo ka plotësuar detyrimin ndaj KQZ-së për dorëzimin raportit vjetor financiar 2020.

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit të partisë

Sipas statutit struktura e organizimit dhe e drejtimit të Partisë së Gjelbër përbëhet:

Organet qendrore:

- a) Këshilli i Përgjithshëm Drejtues (Organi më i lartë mes dy Kongreseve).
- b) Kryetari (Drejtuesi më i lartë politik)
- c) Kongresi (Organi më i lartë vendimarrës)

Në vitin 2020 organizata numëron mbi 3 800 anëtarë dhe është e organizuar në 50 degë lokale, të grupuara në 12 degë rajonale sipas qarqeve dhe të drejtuara nga 12 Kryesitë e qarqeve.

Selia qendrore e saj ndodhet në Tiranë, në adresën, Rruga "Blv Bajram Curri", Pall 31, Shk 1, Ap 4, Tiranë.

Strukturat vendore janë të ngritura dhe funksionojnë në të gjitha qarqet, por nuk kanë zyra dhe ambjente fikse, në pronësi, përdorim apo me qera dhe nuk kanë funksione administrimi në burimet dhe përdorimet e fondeve të partisë. Kryerja e funksioneve të drejtimit politik dhe funksioneve të tjera ndihmëse bazohet kryesisht në punën vullnetare të anëtarëve të saj. Por për realizimin me sukses të aktiviteteve të financiar nga donatori, në subjektin Partia e Gjelbër ka një të punësuar me kohë të plotë pune.

II. KËRHEVAT FORMALË TË RAPORTIT VJETOR

Veprimtaria ekonomike e partisë administrohet nga Kryetari i Partisë, i cili kontrollon burimet dhe përdorimin e fondeve financiare në funksion të aktiviteteve të dhe qëllimeve të partisë, si dhe shqyrton raportet financiare para dorëzimit të tyre në organet kompetente shtetërore dhe të partisë.

Sistemi i kontabilitetit është i organizuar në selinë qendrore të partisë dhe realizohet nga shërbime vullnetare. Degët në qarqe nuk kanë detyra administrimi.

Sipas deklarimeve të partisë nuk ka organizata që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë siç mund të jenë fondacionet, organizatat e rinisë, etj.

D. PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR DHE STRUKTURA E TIJ

i. Struktura e raportit– kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.

Struktura e raportit vjetor financiar (Pasqyrat financiare) të Partisë së Gjelbër, të publikuara në KQZ, përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performanës (pasqyra e aktiviteteve) dhe pasqyra e flukseve të parasë, si edhe shënime shpjeguese për pasqyrat financiare.

ii. Takimet dhe komunikimet midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.

Menjëherë pas firmosjes së kontratës me KQZ-në, në datën 04.10.2021 u vendosën kontaktet me personin që merret me administrimin e partisë, dhe po në këtë datë u nënshkrua kontrata me Kryetarin e partisë, z.Edlir Petanaj, kontratë në të cilën u përcaktuan termet e angazhimit dhe përgjegjësitë reciproke të palëve.

Në vijim u bashkëpunua në vazhdimësi me personin që merret me çështjet ekonomike dhe të shërbimit kontabël, Z. Andi Hoxha, prej të cilit sigurova raportin vjetor financiar për vitin 2019 dhe 2020, dokumentacionin kontabël, regjistrimet dhe informacione të tjera që lidhen me auditimin.

iii. Paraqitje e përgjithshme e raportit vjetor të partisë politike, përputhshmëria e tij me kërkesat e raportimit.

Kam vlerësuar paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor (pasqyrave financiare), përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, të publikuar nga PGJ-ja për vitin 2020, nëse ato paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrën që të japin paraqitjen e drejtë.

Raporti vjetor financiar, i paraqitur dhe publikuar në KQZ, është hartuar sipas SKK-ve, sipas formës së pasqyrave të kërkuara prej SKK-së për OJF-të, siç përshkruhet në pikën "Standartet e kontabilitetit të zbatueshme" të këtij raporti.

II. KËRKESAT FORMALE TE RAPORTIT VJETOR

A. PËRMBLEDHJE

1. Data e dorëzimit të raportit vjetor			
	Dorëzimi fizik	Po	Datë, 31.05.2021
2. Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	Datë, 31.03.2021
	Identiteti i nënshkruesit	Po	Edlir Petanaj, Kryetari Partisë Andi Hoxha-Financier

B. INFORMACION MBI PARTINË, AUDITUESIN DHE LLOGARITË BANKARE

1. Informacioni për partinë politike	
Emri i partisë politike	Partia e Gjelbër
Adresa e selisë qendrore	Rruga "Blv Bajram Curri", Pall 31, Shk1, Ap4, Tiranë.
Numri i telefonit të selisë qendrore	Nuk ka
Adresa e e-mailit të selisë qendrore të partisë (nëse ka)	pgj.office@gmail.com
2. Informacion për audituesin ligjor	
Emri i audituesit ligjor të caktuar	Violeta Mulla
Adresa e audituesit ligjor	Rr, Pjeter Budi, pall.61/1, ap.14 tirane
Numri i telefonit të audituesit ligjor	069 99 07 937
Adresa e e-mailit të audituesit ligjor.	violetamulla@yahoo.com
3. Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike	
Emri i bankës ku mbahet llogaria	-Raiffeisen Bank
Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Rruga e Kavajës, Tiranë
Numri i telefonit të zyrës së bankës	00355 4 2381 381
Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës.	00355 4 2274 566
Numri i llogarisë bankare	0030047195 - ALL 0040047195 - EUR
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Edlir Petanaj Andi Hoxha

Në tërësi, Grante përshkruar në pjesën e shprehur të përshkruar nga donatori i plotshkruar që në fund të periudhës raportuese kanë qenë për të përdorur. Ky detyrim është realisht në vitin 2021.

C. AKTIVET DHE DETYRIMET

1.Kriteret e klasifikimit të aktiveve	
	<p><u>Përshkrimi natyrës së secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit</u> Sipas natyrës, aktivet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, 31.12.2020 përbëhen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete monetare në arkë dhe në bankë - Aktive afatëgjata materiale, mobilje dhe pajisje zyre
	<p><u>Përshkrimi i vendndodhjen e aktivit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendndodhja e aktiveve materiale është pranë selisë qendrore. - Nuk ka aktive të administruara nga degët e partisë në qarqe dhe bashki, pasi ato nuk kanë zyra dhe detyra administrimi.
	<p><u>Vlerat e tregut të aktivit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur.</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete monetare në arkë dhe në bankë 31.12.2020. Llogaria bankare pranë RAIFFEISEN BANK ALL 306,016 lekë Llogaria bankare pranë RAIFFEISEN BANK EUR.....18,624 euro Mjete monetare në arkë.....2,139 lekë Shuma mjete monetare 2,612,555 lekë - Aktive afatëgjata materiale Aktive afatëgjata materiale, me koston e blerjes dhe të krijimit.....251,282 lekë Amortizimi i akumuluar..... (109,446) lekë Aktive afatëgjata materiale neto.....141,836 lekë
2.Kriteret e klasifikimit të detyrimeve	
	<p><u>Përshkrimi i llojit të secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit</u> Sipas llojit, detyrimet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, 31.12.2020 përbëhen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Detyrime për paga - Detyrime për sigurime shoqërore dhe tatim në burim - Grante me kusht.
	<p><u>Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Furnitore për mallra e shërbime OSHEE sh.a..... 0 lekë AlbTelecom sh.a.....0 lekë UKT Tiranë sh.a 0 lekë Paga të pagueshme.....41,800 lekë Sigurime shoqërore dhe shëndetësore.....16,550 lekë Tatim në burim.....30,000 lekë Grante me kusht (fonde të papërdorura)..... .2,100,840 lekë
	<p><u>Vlera e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Detyrimet ndaj pagave, sigurimeve shoqërore dhe tatimit në burim janë detyrimi i muajit dhjetor 2020 që paguhet deri datë 20 janar 2021. Ky detyrim është i likuiduar në vitin 2021.

- Në zërin *Grante* përfshihet një pjesë e shumës së përfituar nga donatori jopublik që në fund të periudhës raportuese është e papërdorur. Ky detyrim është realizuar në vitin 2021.

D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

Përmbledhje Financiare	
Periudha e raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin).	01 Janar 2020-31 Dhjetor 2020
Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin).	Gjendja e arkës 01.01.2020.....87,719 lekë Gjendja e arkës 31.12.2020.....2,139 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra.	Të përfituara gjithsej5,127,677 lekë
Shuma e përdorur për vitin 2020	Të ardhura nga grantet gjithsej3,026,837 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra.	Shpenzime gjithsej.....2,993,571 lekë
Bilanci në fund të periudhës së raportimit (data e fundit që mbulon periudhën).	31 Dhjetor 2020
Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit.	Aktivi 31.12.2020.....2,754,391 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.	Detyrime 31.12.2020.....2,189,190 lekë

a.Vlerësimi i informacionit dokumentar mbi llogaritë bankare

Nga evidenca dokumentare që kam marrë nga drejtimi i partisë rezulton se Partia e Gjelbër ka hapur një llogari bankare, në dy monedha "Lekë" dhe "Euro", në Banken Raiffeisen Bank sh.a.

Për të dyja monedhat kam marrë lëvizjet e llogarive bankare (bank statement) për të gjithë vitin financiar nga 1 janari 2020 deri në 31 Dhjetor 2020.

Nga auditimi rezultoi se transaksionet janë regjistruar, klasifikuar dhe raportuar në mënyrë të rregullt dhe nuk u konstatuan gabime apo mospërputhje me kërkesat rregullatore.

b.Vlerësimi i dokumentacionit mbështetës të pasqyrave financiare

Kërkova dhe sigurova nga partia dokumentat mbështetës mbi të cilat janë hartuar pasqyrat financiare sipas funksionimit të cikleve dhe llogarive si; mjetet monetare /financimet (statement bankare dhe dokumentet arkës), blerjet/kreditorët (faturat e blerjes së mallrave dhe shërbimeve), aktivet afatgjata materiale (inventarin fizik dhe pasqyrat llogaritëse të amortizimit), pagat dhe sigurimet (listëpagesat, kontratat e

punës), tatimet (deklarimet për tatimin në burim dhe TAP), si dhe dokumente të tjera kontabël, bazë dhe përmbledhës, lidhur me kontribute në natyrë, etj.

Kam shqyrtuar pothuajse të gjithë dokumentet (pasi ato ishin relativisht të pakta në numër), nëse ishin plota, pasqyrojnë transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura gjatë periudhës dhe a përkasin subjektit. Nga verifikimi, nuk u konstatua ndonjë parregullsi domethënëse nga shqyrtimi formal i tyre.

c.Kontrolli i elementeve të aktiveve dhe detyrimeve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar

Mjetet monetare

Nga auditimi i mjeteve monetare në bankë dhe arkë, verifikimi i gjendjeve në fillim të ushtrimit dhe lëvizjeve të ndodhura gjatë vitit rezultoi se gjendjet e tyre në fund të ushtrimit të paraqitura në aktivin e pasqyrës së pozicionit financiar janë të rregullta. Ato konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarin fizik të arkës në fund të ushtrimit dhe paraqiten si vijon:

Gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe në bankë 31.12.2020(Statement bankare dhe inventari fizik i arkës).

Llogaria bankare pranë RAIFFEISEN (ALL).....	306,619 lekë
Llogaria bankare pranë RAIFFEISEN (EUR)	18,624. euro
Mjete monetare në arkë.....	2,139 lekë
Shuma e mjeteve monetare	2,612,555 lekë

Aktivitet afatgjata materiale

Po ashtu u verifikuan dhe gjendjet dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale nga ku rezultoi se pasqyrimi i tyre në aktiv të pasqyrës së pozicionit është i rregullt dhe i kuadruar me inventarin e AAM-ve. Gjendja e aktive afatgjata materiale 31.12.2020 është:

Aktive afatgjata materiale, me koston e blerjes dhe të krijimit.....	251,282 lekë
Amortizimi akumuluar.....(109,446) lekë
Aktive afatgjata materiale neto.....146,836 lekë

Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes është bërë me koston e blerjes dhe në datën e mbylljes së PF-ve paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimin e akumuluar.

Gjatë ushtrimit aktivitet afatgjata materiale janë shtuar për 80,400 lekë dhe janë pakësuar me vlerën e amortizimit vjetor për shumën 28,973 lekë, llogaritur sipas metodës dhe normave të përcaktuara në politikat kontabël.

Të pagueshmet

Edhe nga verifikimet e gjendjeve dhe lrvizjeve tw llogarive të pagueshme nuk u evidentuan mospërputhje dhe parregullsi, krahasuar me kontabilitetin dhe gjendjet e deklaruarra dhe janë si vijon:

Furnitore për mallra e shërbime

Sigurime shoqërore dhe shëndetësore.....	41,800 lekë
Tatim në burim.....	30,000 lekë
Grante me kusht (fonde të përdorura).....	2,100,840 lekë


Nga procedurat e kryera verifikuese për aktivet dhe detyrimet, për ekzistencën, plotësinë, të drejtat dhe detyrimet dhe vlerësimin e tyre nuk rezultuan anomali materiale dhe parregullsi në raportim.

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

	Sipas raportit vjetor	Sipas auditimit të kryer
1. Financimi publik		
Shuma e granteve jopublike të marra	0	0
Data e tranfertës(llogaria bankare ne BKT)	0	0
2. Donacionet private		
Shuma e përgjithshme e raportuar	5,127,677 lekë	5,127,677 lekë
Shuma e donacioneve në para	5,127,677 lekë	5,127,677 lekë
Shuma e donacioneve në natyrë	0	0
Paraqitja e një liste të donatorëve		Green Forum of Sweden
Paraqitja e të gjitha deklarimeve bankare		
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma)		24,8410 euro 17,220 euro
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (data)		30.04.2020 12.10.2020
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (donatori)		Nuk ka diferenca në vlerë midis deklarimeve bankare dhe pasqyrimi i tyre në raportet financiare. Të ardhura nga grantet joqeveritare

		janë tërësisht lëvruar me bankë.
Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		Nuk ka
A përputhen shifrat e përgjithshme?		Po
Respektimi i kufirit të donacionit		
3. Financimi nga burimet e vetë partisë		
Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	0	0
Kuotat e anëtarësisë	0	0
Botimet	0	0
Shtypshkronja	0	0
Marrje me qera	0	0
Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		
Kuotat e anëtarësisë (jane arketuar me arke nga degët)	0	0
Botimet	0	00
Shtypshkronja	0	0
Marrje me qera	0	0
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma)		
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (data)		
4. Huatë/Kreditë		
Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0	0
Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	0	0
Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	0	0
5. Marrja e të ardhurave		
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë përkatëse.	Po	Nuk u kostatuan parregullsi



Kontributet e Specifikuara

Përveç të ardhurave nga grantet joqeveritare nuk janë evidentuar dhe deklaruar të ardhura të tjera që kanë kërkesa të veçanta transparence dhe raportimi. Të ardhurat e tjera në rezultat në shumën 73, 623 lekë janë diferenca konvertimi për transaksionet në monedhë të huaj në data të ndryshme me kurse këmbimi të ndryshme.

B. ANALIZA E BURIMEVE

a.Financimi nga burimet jo publike

Donatorët e lejuar

Në raportin vjetor të partisë janë evidentuar të ardhura nga donacionet dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

Burimet e palejuara

Në raportin vjetor të partisë nuk janë evidentuar të ardhura nga burime të palejuara dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

Kontributet në natyrë

Në raportin vjetor të partisë nuk janë evidentuar të ardhura nga kontribute në natyrë dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

b.Financimi nga burimet e vetë partisë politike

Klasifikimi me zëra i të ardhurave nga burimet e vetë partisë

Nuk ka të ardhura të ardhura të realizuara nga burimet e vetë partisë.

c.Huatë/Kreditë

Në raportin vjetor të partisë për vitin 2020 nuk janë evidentuar të ardhura nga huatë dhe kreditë dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

IV. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE SIPAS NATYRËS

Strukturat vendore nuk kanë funksione administrative në burimet dhe përdorimet e fondave të partisë dhe për rrjedhim nuk ka evidencë ndarje të shpenzimeve sipas degëve në qarqe.

	Shpenzimet e deklaruar në raportin vjetor	Faturat e paraqitura	Dokumentet mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Shpenzime për aktivitete (qira salle, logjistikë, catering)	1,714,440,	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	1,714,440
Shpenzime administrimi	259,441					259,441
Qira	90,000	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	90,000
Kancelari	72,000	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	72,000
Telefoni, internet	32,000	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	32,000
Komisione Bankare	21,468	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	21,468
Taksa vendore	15,000	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	15,000
Shpenzime amortizimi	28,973	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	28,973
Kuota vjetore e anëtarësisë në Org të huaja	110,530	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	110,530
Shpenzimi Auditimi	49,000	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	49,000
Paga dhe shpërblime	560,160					560,160
Shpenzime page	480,000	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	480,000
Shpenzime sigurimesh	80,160	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	80,160
Komunikimet	300,000					
Botimet	300,000	Të gjitha faturat e regjistruara	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	300,000
SHUMA	2,993,571					2,993,571

Strukturat vendore nuk kanë funksione administrimi në burimet dhe përdorimet e fondeve të partisë dhe për rrjedhim nuk ka evidencë ndarje të shpenzimeve sipas degëve në qarqe.

ANALIZA

a. Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruarra dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë.

Të gjitha shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit 2020 janë të autorizuara dhe të kontrolluara nga qendra e partisë. Autorizimi i shpenzimeve, dokumentimi, regjistrimi, klasifikimi dhe raportimi bëhen nga qendra e partisë. Kjo ndodh sepse sipas organizimit të partisë degët në qarqe nuk kanë kopetenca të pavarura që të përdorin fonde dhe të administrojnë pasuri. Gjithçka kryhet e përqendruar.

b. Verifikimi

Verifikimet e transaksioneve që lidhen me shpenzimet për ndodhjen, plotësinë, saktësinë, prerjen e periudhës dhe klasifikimin u kryen mbi bazën e vlerësimit të rrisqeve, që janë karakteristikë për aktivitetin e partive politike.

Bazuar në faktin se viti 2020 nuk kishte aktivitete zgjedhore por vetëm ato të funksionimit të përhershëm, si rreziqe kryesore në lidhje me shpenzimet u vlerësuan:

- mosnjohja e ndonjë blerje për të fshehur burimin
- deklarimi me shuma më të ulta se sa tregojnë dokumente,
- mungesa e faturave të rregullta për shpenzimet e kryera,
- etj.

Si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve të vlerësuara, si procedurë thelbesore u ndoq ajo e verifikimit të faturave origjinale të blerjes me pagesën e kryer dhe pasqyrimin të tyre në llogaritë e blerjes (furnitorët) dhe të shpenzimeve sipas kategorive.

Nga verifikimet e kryera me përzgjedhje nuk rezultoi asnjë parregullsi materiale.

Shpenzimet e amortizimit ishin llogaritur dhe paraqitur në përputhje me metodën dhe normat e përcaktuara nga drejtimi, të shpjguara në shënimet e pasqyrave.

Po ashtu u kërkua informacion për mallra dhe shërbime të marra në natyrë dhe sipas deklaratave të drejtimit nuk janë evidentuar shpenzime apo kontribute të kësaj natyrë.

V. SINTEZA DHE OPINIONI AUDITIMIT

A. SINTEZA

a. Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve.

- Përfundova procesin e auditimit bazuar në vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale, mora evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, përdora procedurat që gjykova të nevojshme dhe nuk evidentova anomali materiale si rezultat i gabimit, mashtrimit, përjashtime të qëllimshme apo informacione të deformuara në pasqyrat financiare 2020 të deklaruarra nga Partia e Gjellbër në KQZ, në të gjitha elementet, aktivin, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

- Po ashtu vlerësuam politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi në pjesën e shënimeve të PF-ve, dhe arritëm në konkluzionin se ato janë të drejta dhe të përshtatëshme për aktivitetin që zhvillon një parti politike.
- Lidhur me kërkesat specifike të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike" dhe udhëzimet e KQZ-së si, burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, burimet e lejuara, kufizimet, dokumentimit dhe të regjistrimit të tyre, identifikimin e dhuruesve, zbatimin e rregulave të publikimit të tyre, etj., nuk u gjetën parregullsi dhe shkelje ligjore.

b. Lista e parregullsi të gjetura gjatë procesit të auditimit.

- Në vazhdim të çështjeve të shpjeguara më sipër gjatë procesit të auditimit nuk janë konstatuar gabime materiale, në të gjithë elementet e aktivitetit, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe përjashtime të qëllimshme apo informacione të deformuara në pasqyrat financiare.

B. OPINIONI

I. Opinioni mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare 2020

Opinioni pa rezervë

Kam audituar pasqyrat financiare të Partisë së Gjellbër (si pala përgjegjëse e raportimit), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.


Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë së Gjellbër më datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të), Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse.)

Baza për opinionin pa rezervë

Pasqyrat financiare 2020 të dorëzuara në KQZ dhe të publikuara prej saj, janë përgatitur mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të SKK-ve dhe janë paraqitur plotësisht sipas setit të pasqyrave financiare që aplikohen për organizatat jofitimprurëse.

II. Opinioni mbi kërkesat të tjera ligjore dhe rregullatore

Në përfundim të verifikimeve dhe informacioneve të marra, në referencë me kërkesat, kufizimet dhe detyrimet specifike të kërkuara prej ligjit "Për Partitë




Politike”, i ndryshuar dhe udhëzimevë të KQZ-së, për çështjet që gjejnë zbatim në aktivitetin e kryer për ushtimin 2020, opinionin ynë është si vijon:

- Burimet e financimit të aktivitetit politik të Partisë së Gjelbër për periudhën raportuese 2020, kanë ardhur nga donacionet e dhëna nga donatori i vetëm Green Forum of Sweden. Të ardhurat e realizuara dhe të deklaruara janë në përputhje me burimet e lejuara nga ligji “Për Partitë Politike”.
- Nuk u evidentuan marrje të fondeve jopublike, në para apo në natyrë, nga dhurues të identifikuar dhe të pidentifikuar, me shuma mbi 100 mijë lekë dhe të papublikuar.
- Nuk u evidentuan parregullsi dhe anomali materiale në zbatimin e kërkesave të legjislacionit kontabël dhe atij tatimor, për dokumentimin, merrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe deklarimin e veprimeve dhe faktet ekonomike që i përkasin partisë, të lidhura me aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

Violeta MULLA

Audituese Ligjore

Tiranë, më 08.10.2021



**AUDITUESE
LIGJORE
VIOLETA MULLA
ANETARE E I.E.K.A**

A. INFORMACIONI LIGJOR

L. Kusadri ligjor

Ashtu si referohet dhe në kontratën e shërbimit, auditimi ligjor i raporteve vjetore financiare të partive politike kërkohet dhe realizohet në zbatim të kërkesave të:
 - Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar
 - Ligjit nr. 10091, datë 08.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar”, i ndryshuar,
 - Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyret financiare”,
 - Legjislacionit në fushën fiskale, si dhe
 - Akteve nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim.
 Nga pikëpamja profesionale kryerja e auditimit ligjor bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) të miratuara dhe të publikuara nga Bordi i standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të dhënies së sigursë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAK), të detyrueshme për zbatim nga ligji për auditimin i sipërcituar.